



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.67/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në konfliktin administrativ të paditësit “A...” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “....” SHPK me seli Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/310, 330/2017 të datës 20.10.2020, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të datës 26.09.2022, të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit G.B dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës M.K, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “A...” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “....” SHPK me seli Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/310, 330/2017 të datës 20.10.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 14.10.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/310, 330/2017 datë 20.10.2020, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, shkeljeve të

dispozitive procedurale dhe për shkak të rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit, dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar në tërësi padia e paditësit, të refuzohet si i pa bazuar aktvendimi i kontestues dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia kthej shumën e përgjithshme prej 11,636.11€. Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e autorizuar e paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe pranë të gjitha pretendimeve të cekura në të. Në lidhje me këtë çështje deklaroi se ka pranuar ekspertizën financiare të datës 12.04.2022, si dhe plotësimin e ekspertizës financiare të datës 20.06.2022. Në plotësimin e ekspertizës financiare ka vërejtje, për arsye se nga kalkulimet e bëra nga ekspertja, vlerat faturale për DUD-at kontestues sipas të njëjtës nuk janë të harmonizuara me vlerat e Transaksioneve bankare për shumën totale prej 2,207.59€ për urdhërpagesën e datës 11.04.2017, si dhe shumën prej 1,534.09€, për urdhërpagesën e datës 08.05.2017. ndërsa për DUD-in nr.9630 ka një ndryshim prej 21,250USD, ndërmjet vlerës faturale dhe asaj të transaksionit, e për të cilin DUD paditësi nuk ka mundur të gjej dëshmi se në këtë pagesë është paguar edhe një DUD tjetër eventual. Tutje përfaqësuesja e autorizuar e paditësit i propozon gjykatës që të veproj sipas kësaj padie dhe kërkesëpadie, duke aprovuar të njëjtën si të bazuar dhe duke anuluar vendimin kontestues, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia kthej mjetet monetare të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore në shumë prej 9,520.37€, si të cekur në ekspertizën financiare. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 23.07.2021 e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi e të paditurës deklaroi se paditura e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Konsideron se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, dhe se pretendimet e palës për shkelje esenciale nuk ekzistojnë, ngase nuk ka mundur t'i vërtetoj me asnjë provë të vetme. I

propozon gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin e refuzon në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe lenë në fuqi aktvendimin e kontestuar të paditurës si të ligjshëm. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 26.09.2022 ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi nr.01.3.2.2/310,330/2017 i datës 20.10.2020 dhe nr.310, 330 i datës 19.06.2017, DUD-at nr.9028/24.04.2017, nr.8772/21.04.2017, nr.9185/26.04.2017, nr.10312/09.05.2017, nr.9630/01.05.2017, nr.6380/24.03.2017, nr.12329/30.05.2017, nr.3928/28.03.2017, nr.13698/25.06.2016 dhe nr.11285/19.05.2017, Faturat nr.PLS17004, nr.PLS17008, nr.PLS17010, nr.VI-2017/12, nr.PLS17013, nr.SJ-20160223, nr.PLS17012, Transaksionet bankare ndërkombëtare të datës 11.04.2017, 08.05.2017, 25.02.2016, përgjigja në padi e datës 23.07.2021, Ekspertiza financiare e datës 12.04.2020, Plotësim ekspertiza financiare e datës 20.06.2022, Proceset mbi përcaktimin e Vlerës së mallrave, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës nr.310/12.05.2017, nr.330/24.05.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti “A...” ShPK me seli në Prishtinë, këtu paditësi, përmes DUD-ave nr.R-9028/24.04.2017, R-9185/26.04.2017, R-10312/09.05.2017, R-9630/01.05.2017, R-11285/19.05.2017, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Interevropa, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj

përmes proceseve mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës. Nuk është kontestues as fakti se paditësi me datë 12.05.2017 dhe 24.05.2017 ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura me datë 19.06.2017, ka sjell aktvendimin nr. 01.3.2.2/310, 330/2017, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtij paditësi, tutje lidhur me këtë lëndë kjo Gjykatë duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin nr.1272/17 të datës 16.09.2020, ka aprovuar padinë e paditësit, ka anuluar vendimin 01.3.2.2/310, 330/2017 të datës 19.06.2017, duke e kthyer lëndën në rivendosje, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtij Aktgjykimi në Rishqyrtim – rivendosje ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/310, 330/2017 të datës 20.10.2020, me të cilin prapë ka refuzuar ankesën e këtij paditësi e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 14.10.2020 ka iniciuar prapë këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “A...” ShPK me seli në Prishtinë, këtij paditësit, për rishqyrtimin e vendimeve R-9028/24.04.2017, R-9185/26.04.2017, R-10312/09.05.2017, R-9630/01.05.2017, R-11285/19.05.2017 të lëshuar nga ZBD Interevropa. E paditura rivlerësimin e mallit e ka bërë pasi që dokumentet përcjellëse të paditësit i ka vlerësuar si prova të pa-mjaftueshme pasi që: subjekti këtij paditësi nuk ka ofruar deklaratën eksportuese të shtetit eksportues dhe kontrata e shitblerjes me eksportuesin është e mangët , nuk dallon nga fatura e mallit dhe e njëjta është e panëshkruar nga subjekti ankimor, ndërsa Dogana e Kosovës lidhur me mallin lëndor ka bërë analiza të çmimeve duke konkluduar se çmimet e prezantuar nga subjekti nuk mund të pranohen si reale, andaj ka caktuar vlerë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme, respektivisht të dhënat nga dosja e vlerës si dhe në bazë të zhdoganimeve të mallrave të ngjashëm. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin

kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.2145/20 të datës 25.03.2022 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ me ekspertin financiar M.M e cila ka pasur për detyrë që nga dokumentet financiare të padisë së paditësit të konstatoj diferencën e mjeteve të paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ave kontestues, të identifikoj transaksionet bankare ndërkombëtare të paguara për faturat sipas DUD-ave kontestues i më lartë, si dhe të bëjë harmonizimin e faturave përcjellëse të mallit sipas DUD-ave si më lartë në raport me dokumentacionin tjetër përcjellës. Ekspertja financiare në ekspertizën financiare të datës 12.04.2020, plotësim e ekspertizës të datës 20.06.2022 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ekspertizën dhe plotësim ekspertizën e ka bërë konform detyrave të dhëna nga gjykata, ku secilën urdhërpagesë bankare ndërkombëtare, bazuar në përshkrimin e pagesave e ka barazuar me faturat që janë kontestuese dhe jokontestuese dhe nga verifikimet e bëra dhe të paraqitura në formë tabelore ka rezultuar në mosharmonizim të transaksioneve bankare dhe faturave të cilat janë bërë pagesat sipas rubrikës përshkrimi i pagesave.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë plotësim ekspertizës së lartpërmendur dhe plotësimi të saj, ngase të njëjtat i përmbajnë elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i

vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë konflikt administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit për shkelje esenciale të dispozitave të KDA-së, dhe atë të neneve 33 dhe 34, me arsyetimin e paditësit se zyra e pranimit qendror e Doganës së Kosovës, ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit edhe pse ka qenë dashur të aplikohet metoda e parë e vlerësimit konform nenit 33, të KDA-së, dhe vetëm në rast se nuk mund të aplikohet metoda e parë e vlerësimit atëherë neni 34, i KDA-së parasheh që metodat e vlerësimit të aplikohen sipas radhës, e i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës, se në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, kjo pasi që nuk ka prezantuar dokumentacion të harmonizuar në mes të transfereve bankare dhe faturave të mallit lëndor kontestues, si dhe dokumentacionin tjetër mbështetës për ta provuar vlerën e transaksionit si të pakontestueshme, e të cilin arsyetim, Gjykata e pranon si të drejtë, konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura. Pastaj e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provën materiale si faturat e mallit, e njëjta nuk ka arrit të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër e cila është në harmoni të plotë me shumën dhe përshkrimin e faturës për mallin e importuar.

Tutje Gjykata vlerëson se nuk është i bazuar as pretendimi tjetër i paditësit, lidhur me shkeljet e dispozitave procedurale nga e paditura, e që lidhet me mos verifikimin e provave

në të cilat mbështetet aktvendimi kontestues, pasi që nga ekzaminimi i aktvendimit kontestues shihet qartë se e paditura në procedurë të ankesës, ka administruar si provë të gjithë dokumentacionin përcjellës të mallit mirëpo e njëjta me të drejtë nuk i ka vlerësuar si të mjaftueshme sepse mallrat e importuara me DUD-at kontestues R-9185 paditësi ka bashkangjitur faturën PLS17008 të datës 04.06.2017 në vlerë prej 41,931.00USD, për DUD-in R-10312 paditësi ka bashkangjitur faturën PLS17010 të datës 05.09.2017 në vlerë prej 32,111.00USD, për DUD-in R-9028 paditësi ka bashkangjitur faturën PLS17004 të datës 09.03.2017 në vlerë prej 294.00 USD, ku pagesa për këto fatura është bërë përmes transaksionit bankarë të datës 11.04.2017 në vlerë prej 92,842.00€ të realizuar në bankën TEB, mirëpo kjo pagesë nuk harmonizohet në kuptim të shumës me vlerën totale të këtyre faturave. Tutje paditësi për DUD-in kontestues R-11285 ka bashkangjitur faturën PLS17012 të datës 04.07.2017 në vlerë prej 20,404.00USD, mirëpo transferi bankar i datës 08.05.2017 i realizuar në bankën TEB, për të cilin paditësi pretendon se është bërë pagesa e kësaj fatura, gjykata ka konstatuar se nuk harmonizohet me vlerën e faturës të këtij DUD-i kontestues. Gjithashtu paditësi ka bashkangjitur edhe faturën nr.SJ-20160223 të datës 07.04.2017 në vlerë prej 21,250.00USD për DUD-in kontestues R-9630, mirëpo transferi bankar i datës 25.02.2016 në të cilin paditësi pretendon se është paguar kjo faturë, nuk harmonizohet me vlerën e faturës. Nga ana tjetër e paditura posedon informacione nga Dosja e Vlerës dhe zhdoganimet të mallrave të ngjashme, ku si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor ka qenë se e paditura Dogana e Kosovës është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, neni 35 i Kodit Doganor dhe Akcizave respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor, janë provë e bazuar për tu rivlerësuar malli lëndor sipas nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjithmonë deri sa nuk dëshmohet ndryshe me dokumentacion përcjellës nga paditësi.

Në vijim Gjykata, pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se:
“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta

dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ” Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe*

(d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij". Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsytim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezultoi të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provojë edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, paragraf 1, dhe nenit 46, paragraf 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.67/22 datë 26.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.